

MUZAFER XHAXHIU

BIBLIOTEKA

854-1

Xh40

The book cover features a stylized illustration of a tree with dark, angular branches against a blue background. A large, bright yellow sun or moon is positioned behind the branches. The title is written in a stylized, blue font with a red shadow effect.

vargje për
dashurinë

814-1
2440

MUZA FER XHAXHIU

LIBRARI
32 915

VARGJE

14242

PËR DASHURINË

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1963

A T D H E U

NUK ËSHTË VALLË KJO POEZI?

Rri e mendoj herë herë me mërzi,
Ç'është poezia sot kur me raketë
Njeriu e la pas çdo fantazi,
E kur në vargje yjt duken të zbetë!

E puthi emblema hënën romantike
Dhe yjet një nga një do t'i trazojë...
Po a nuk është vall' kjo poetike,
Që e frymëzon poetin të këndojë!

NË DITËLINDJEN E PARTISË

Ne,
që dje zvarriseshim si hije
dhe s'kishim moshë,
ne,
një milion pikpyetje
në një shoshë,
 (se shoshë ish bërë Shqipëria)
me mijra mijra vrima,
me dete,
 male,
 ajër plot,
dhe ne na zihej fryma,
ne sot drejt majave marshojmë,
mëngjezeve të artë
këpusim trëndafilat
lart
në shtigjet partizane
dhe i mbjellim në kopshtije...
Ne
dje zvarriseshim si hije
dhe s'kishim moshë,
se moshë hijet s'kanë,

lindnim të mplakur,
të lodhur që në drekë,
nga horizonti i përgjakur
i hidhënim sytë
dhe pritnim shumë,

oh, sa shumë!

mbrëmjen,
se dhëmbjet do t'i yshtnim
me gjumë...

Tani

s'ka pleq në vëndin tim,
të gjithë: njëzetvjeçarë!

Ne lindëm

kur shkundte stuhia,
njëzet vjet më parë
kur lindi

Partia!

Parti!

atdheun tonë e veshe
(me bruc dje, me qeleshe)
me kominoshet e puntorit.

Ti nënë njëzetvjeçare,

e urtë si koha,

të falen bijt njëzetvjeçarë!

Parakalojmë ne

në ditëlindjen tënde,

mbi shpatulla

planet mbajmë

— viganët pesëvjeçarë —

Kur ngecim

në hap të ecim

na mëson,

se rruga s'është e shtruar

në asfalt...

Né,
kryet lart,
marshojmë...

marshojmë...

në hap me ritmet socialiste,
se kemi ty në ballë

Partia leniniste!

ATË DITË NËNDORI...

Mbi supe ju mbanit
tufanet e maleve,
vërshimet e prrenjve
plot zhurmë...

Dashuri e urrejtje
ju sillnit me vete,
aromën e luleve,
që kurrë s'i than
cingërima,
të shkrepave erën e ashpër,
kur shkrep vetëtima...

Ju zbritët
tabore-tabore
me shpresa dëshira
në Vlorë...

Një ditë me shi,
me furtunë,

flamurin,
rrahur në djell e stuhijë,
çpalosët
Nga Vjosa në Bunë...
Atë ditë nëndori

gjëmuan fushat dhe malet,
krokëllitën në varre,
mbuluar pesë shekuj me radhë,
eshtrat shqiptare...

U derdh anembanë
urrejtja stuhi...

U tund Shqipëria...
Nga vargu i shekujve
thellë

shkëlqeu liria..

Vlorë...

që puthe me dallgët e detit
si një vashë,

që për të parën herë
të dashurit i hap krahërorë.

Vlorë...

që rrëmben rrufetë
nga Malet e Vetëtimës

e i shuan në det

si plagët — zjarr me ujë,

ti Vlorë e ëmbël e ullishteve,
e sërta Vlorë strall,

rrahur në zjarr,

jatak për lebër,

myzeqarë...

ti zonjë e madhe Vlorë

të ka hije

ballët t'i zbukurosh

me kurorën që të dha

historia...

Atë ditë nëndori

nga Vlorë nisi udhën

Shqipëria

mbi gërmadhat që i la robëria.

Krenare hodhi këmbët
duke mbajtur mbi shpatulla

plagë

e shpresa në sy

— të përgjakura —

Tërbimin e furtunave çau,

që iu rreshën mbi kokë,

udhëkryqe...

humnera...

kalkan e thëllimit,

gjer çeli pranvera

Nëndorit të madh

të çlirimit...

PARAKALON 1 MAI

Sheboja kundërmon
e bari i njomë
kryet lëshon përpjetë
 i asdisur...
e një afsh plot aromë
i ngroht,
 i ëmbël
nga toka e rime avullon...
Tirana është stolisur...
(Si nuse është stolisur kjo Tiranë!)
Në sheshe,
 nëpër rrugë,
 anembanë
flamujt
si një buqetë lulëkuqesh
me gjuhëza prej flake
me qiellin ligjërojnë.
Rrugët gjëmojnë...
harë,
 gëzim,
parakalon 1 Mai
i veshur në blerim...